



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

23264

UDHËZIM
Nr. 36 Datë 17¹² 2019

**“PËR PËRGJEGJËSITË E PËRDORUESVE NË SISTEMIN INFORMATIK TË MENAXHIMIT
FINANCIAR PËR MODULIN E PËRGATITJES SË BUXHETIT, MODULIN E MENAXHIMIT
TË INVESTIMEVE PUBLIKE DHE MODULIN E MONITORIMIT TË BUXHETIT DHE
PORTOFOLIT TË PROJEKTEVE”**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të VKM nr. 527, datë 25.07.2019 “Për krijimin e bazës shtetërore të sistemit informatik të menaxhimit financiar”, të Udhëzimit të Ministrit përgjegjës për financat nr. 7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, të Udhëzimit të Ministrit përgjegjës për financat nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Udhëzimit të Ministrit përgjegjës për financat nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Ministri i Financave dhe Ekonomisë:

UDHËZON

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe përgjegjësive të përdoruesve që do të kenë akses në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIMF) për modulën e përgatitjes së buxhetit, modulën e menaxhimit të investimeve publike dhe modulën e monitorimit të buxhetit dhe portofolit të projekteve.

II. PALËT E PËRFSHIRA NË KËTË PROCES

1. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit (DPB)
2. Njësitë e Qeverisjes Qendrore (NJQQ)
3. Drejtoria e Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar;
4. Drejtoria e Menaxhimit TIK për Ministrinë e Linjës,

5. AKSHI.

III. SISTEMET INFORMATIKE TË NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E PROCESIT

1. Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar (SIMF) për përgatitjen dhe monitorimin e Programit Buxhetor Afatmesëm.
2. Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI) për shkëmbimin e të dhënave të lidhura me qëllimin e politikës së programit dhe treguesit respektiv të performancës, objektivave specifik dhe treguesve respektiv të performancës dhe masave prioritare lidhur me programet zhvillimore dhe projektet kombëtare strategjike.
3. Sistemi Informatik i Menaxhimit të Ndihmës së Huaj për shkëmbimin e të dhënave për disbursimet e kryera nga donatorët për projektet e investimeve publike me financim të huaj.

IV. PËRGJEGJËSITË E PËRDORUESVE NË MODULIN E PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM

• Ministria përgjegjëse për financat

Struktura përgjegjëse për planifikimin buxhetor ka këto përgjegjësi:

- Struktura përgjegjëse për planifikimin buxhetor, për çdo cikël buxheti, hedh ose rishikon në modulën e PBA, respektivisht për fazën strategjike dhe për fazën teknike, tavanet buxhetore në nivel NJQQ-je. Struktura përgjegjëse për planifikimin buxhetor, përcakton tipin e tavanit respektivisht për fazën strategjike duke aktivizuar opsionin tavan indikativ dhe për fazën teknike duke aktivizuar opsionin tavan i pandryshueshëm.
- Struktura përgjegjëse për planifikimin buxhetor përcakton në fillim të çdo cikli të planifikimit buxhetor kufirin e lejuar të rritjes së shpenzimeve për kostimin e politikave ekzistuese. Ky kufi (threshold) zbatohet për të gjitha Ministrinë e Linjës dhe Institucionet Qendrore, në nivel programi buxhetor.
- Ministria përgjegjëse për financat, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për planifikimin buxhetor afatmesëm, mbështetur në argumentat e njësisë së qeverisjes qendrore mund të rishikojë kufirin e lejuar të atij programi buxhetor.
- Struktura përgjegjëse për planifikimin buxhetor, në muajin Dhjetor, rishikon tavanet buxhetore në nivel NJQQ-je në përputhje me ligjin e buxhetit të miratuar për vitin e ardhshëm.

1. Njësitë e Qeverisjes Qendrore

1.1. Përgjegjësia e Drejtuesve dhe Anëtarëve të EMP në procesin e përgatitjes së PBA

- Drejtuesi i çdo Ekipi të Menaxhimit të Programit hedh, shton ose fshin të dhënat për anëtarët e ekipit të programit buxhetor.

- Drejtuesi i çdo Ekipi të Menaxhimit të Programit ruan të dhënat për anëtarët e ekipit të programit buxhetor.
- Drejtuesi i çdo Ekipi të Menaxhimit të Programit plotëson deklaratën e politikës së programit duke përcaktuar qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës në nivel impakti ose rezultati në sistemin AFMIS.
- Drejtuesi i çdo Ekipi të Menaxhimit të Programit rishikon qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës nga lista e krijuar në sistemin AFMIS.
- Drejtuesi i çdo Ekipi të Menaxhimit të Programit në përfundim të plotësimit të deklaratës së politikës së programit ruan ndryshimet dhe dërgon deklaratën për miratim tek nëpunësi autorizues.
- Drejtuesi i EMP në përfundim të procesit të kostimit të politikave ekzistuese dhe të reja nga anëtari i EMP, aprovon ose kthen për rishikim kërkesat buxhetore për politikat ekzistuese dhe të reja.
- Anëtari i Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor ka të drejtë të aksesojë të dhëna vetëm për programin buxhetor ku është caktuar si përdorues.
- Anëtari i EMP-së ka të drejtë të krijojë një produkt të ri për shpenzimet korrente në dritaren e kostimit të politikave të reja ose të rishikojë sasinë dhe koston e një produkti ekzistues që paraqitet si propozim për politika të reja mbështetur në përcaktimet e udhëzimit standard të përgatitjes së PBA.
- Anëtari i EMP-së ka të drejtë rishikojë koston dhe sasinë e produkteve ekzistuese në dritaren e kostimit të politikave ekzistuese.
- Anëtari i EMP-së ka të drejtë të zgjedh nga lista e projekteve dhe produkteve që aksesohet nga moduli i PBA përmes modulit të MIP, projektin dhe produktin/produktet që do t'i paraqes si propozim për politika të reja. Anëtari i EMP-së ka të drejtë të kostojë produktet e përzgjedhura.
- Anëtari i EMP-së plotëson me të dhëna dhe vlerat e synuara përgjatë periudhës afatmesme për treguesit e performancës që shfaqen në dritaren e kostimit të politikave ekzistuese dhe politikave të reja.
- Anëtari i EMP-së në përfundim të procesit të përcaktimi të produkteve, kostove respektive dhe vlerave të synuara të treguesve të performancës për programin buxhetor ruan të gjitha ndryshimet dhe dërgon për miratim tek Drejtuesi i EMP-së.
- Anëtari i EMP-së, ka të drejtë të propozojë rishikimin e produkteve ekzistuese apo futjen e një produkti të ri për shpenzimet korrente, përmes dritares së politikave të reja në modulën e PBA, të cilat i dërgon për miratim tek Drejtuesi Ekipit të Menaxhimit të Programit.
- Drejtuesi i çdo Ekipi të Menaxhimit të Programit miraton ose refuzon propozimin për rishikimin e produkteve ekzistuese apo krijimin e një produkti të ri dhe dërgon për miratim tek dhe nëpunësi autorizues.
- Pas miratimit nga Nëpunësi autorizues, në rastin e një produkti të ri nga shpenzimet korrente, në sistem gjenerohet Kodi i ri, i përkohshëm. Kodet e gjeneruara bëhen të

vlefshme pas miratimit përfundimtar të produktit të ri nga struktura përgjegjëse për planifikimin buxhetor në ministrinë përgjegjëse për financat.

1.2. Përgjegjësia e Nëpunësit Zbatues në procesin e përgatitjes së PBA

- Nëpunësi zbatues i njësisë së qeverisjes qendrore hedh ose rishikon detajet për çdo program buxhetor mbështetur në strukturën e programeve të njësisë së qeverisjes qendrore.
- Nëpunësi zbatues i njësisë së qeverisjes qendrore përcakton ndarjen e taveveve sipas programeve për çdo fazë të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm. Nëpunësi zbatues i njësisë së qeverisjes qendrore hedh ndarjen e taveveve buxhetore të njësisë së qeverisjes qendrore në sistemin SIMF dhe e dërgon propozimin e bërë për miratim tek nëpunësi autorizues.

1.3. Përgjegjësia e Nëpunësit Autorizues në procesin e përgatitjes së PBA

- Nëpunësi Autorizues përgatit ose rishikon misionin e njësisë së qeverisjes qendrore të cilin e hedh në dritaren respektive pasi është miratuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.
- Nëpunësi Autorizues miraton ose kthen për rishikim deklaratën e Politikës së çdo Programi Buxhetor.
- Nëpunësi Autorizues miraton ose kthen për rishikim ndarjen e taveveve për të gjitha programet buxhetore, në të dyja fazat e përgatitjes së PBA.
- Nëpunësi autorizues miraton ose kthen për rishikim kërkesat buxhetore për financimin e politikave ekzistuese për çdo program buxhetor.
- Nëpunësi autorizues miraton ose kthen për rishikim kërkesat buxhetore për financimin e politikave të reja për çdo program buxhetor.

1.4. Përgjegjësitë e Drejtuesit dhe Anëtarëve të EMP-së, Nëpunësit Zbatues dhe Nëpunësit Autorizues në procesin e miratimit dhe zbatimit të ligjit vjetor të buxhetit

- Anëtari i EMP, gjatë muajit Dhjetor, rishikon kërkesat buxhetore për politikat ekzistuese në përputhje me tavanin buxhetor të programit të miratuar në ligjin e buxhetit për vitin e ardhshëm.
- Anëtari i EMP, gjatë vitit buxhetor rishikon sasitë e planifikuara të produkteve në rast transferimi të fondeve buxhetore.
- Anëtari i EMP, gjatë vitit buxhetor hedh sasitë faktike të produkteve dhe treguesve të performancës, në fund të çdo katërmujori, për efekt të përgatitjes së raporteve të monitorimit.
- Drejtuesi i EMP, gjatë muajit Dhjetor miraton dhe dërgon për aprovim tek nëpunësi autorizues, kërkesat buxhetore për politikat ekzistuese të rishikuara në përputhje me tavanin buxhetor të programit të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit.
- Drejtuesi i EMP, gjatë vitit buxhetor aprovon/kthen për rishikim sasitë e planifikuara të produkteve në rast transferimi të fondeve buxhetore dhe dërgon për aprovim tek nëpunësi autorizues.

- Drejtuesi i EMP, gjatë vitit buxhetor aprovon ose kthen për rishikim sasi të faktike të produkteve dhe treguesve të performancës, në fund të çdo katërmujori, për efekt të përgatitjes së raporteve të monitorimit dhe dërgon për aprovim tek nëpunësi autorizues.
- Nëpunësi zbatues i Njësisë së Qeverisjes Qendrore, në muajin Dhjetor, rishikon ndarjen e tavaneve buxhetore të programeve në përputhje me ligjin e buxhetit të miratuar për vitin e ardhshëm.
- Nëpunësi autorizues i Njësisë së Qeverisjes Qendrore në muajin Dhjetor, aprovon ose kthen për rishikim, kërkesat buxhetore të NJQQ të ripunuara në përputhje me ligjin vjetor të buxhetit.
- Nëpunësi autorizues, gjatë vitit buxhetor, miraton ose kthen për rishikim sasi të planifikuara të rishikuara të produkteve që preken nga transferimi buxhetor.
- Nëpunësi autorizues, gjatë vitit korrent buxhetor, miraton ose kthen për rishikim sasi të faktike të produkteve në fund të çdo katërmujori, për efekt të përgatitjes së raporteve të monitorimit dhe dërgon për aprovim tek nëpunësi autorizues.
- Nëpunësi autorizues, gjatë vitit korrent buxhetor, miraton ose kthen për rishikim sasi të faktike të treguesve të performancës në fund të çdo katërmujori, për efekt të përgatitjes së raporteve të monitorimit dhe dërgon për aprovim tek nëpunësi autorizues.

2. Përgjegjësitë e përdoruesve në modulën e Menaxhimit të Investimeve Publike

2.1. Ministria përgjegjëse për financat

Struktura përgjegjëse për Projektet e Investimeve Publike ka këto përgjegjësi:

- Struktura përgjegjëse për menaxhimin e investimeve publike, në drejtorinë përgjegjëse për buxhetin, kanë akses me të drejta të plota në modulën e PIM.
- Struktura përgjegjëse për menaxhimin e investimeve publike miraton/refuzon kërkesat e Ministrive të Linjës dhe Institucioneve Buxhetore për shpenzime kapitale, bazuar në plotësimin e procedurave aktuale të vlerësimit dhe miratimit të projekteve të investimeve të përcaktuara në modulën e PIM.
- Struktura përgjegjëse për menaxhimin e investimeve publike miraton/refuzon kërkesat e ML/IB për transferime të fondeve buxhetore për shpenzime kapitale, bazuar në plotësimin e akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi
- Struktura përgjegjëse për menaxhimin e investimeve publike, me miratimin e projektit/produktit të ri, miraton edhe Kodin e ri të projektit/produktit të gjeneruar nga sistemi.

2.2. Përgjegjësia e Drejtuesve dhe Anëtarëve të EMP në procesin e përgatitjes së PBA/Investimet Publike

- Drejtuesi i çdo Ekipi të Menaxhimit të Programit hedh, shton ose fshin të dhënat për anëtarët e ekipit të programit buxhetor.
- Drejtuesi i çdo Ekipi të Menaxhimit të Programit ruan të dhënat për anëtarët e ekipit të programit buxhetor.

- Drejtuesi i çdo Ekipi të Menaxhimit të Programit në përfundim të plotësimit të Formularit 1 – Formulari i Identifikimit të Projekt-Idesë, plotësuar nga “Propozuesit e projektit”, mund ta pranojë apo refuzojë projekt idenë.
- Në rast pranimi, pas plotësimit të Formularit 2 – Propozimi i Projektit të Investimit, Drejtuesi i EMP, ruan ndryshimet dhe dërgon atë për miratim tek Nëpunësi Autorizues.
- Anëtari i Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor ka të drejtë të aksesojë të dhëna vetëm për programin buxhetor ku është caktuar si përdorues.
- Anëtari i EMP-së plotëson Formularin 1 – Formulari i Identifikimit të Projekt-Idesë dhe e përcjell për miratim tek Drejtuesi Ekipit të Menaxhimit të Programit.
- Anëtari i EMP-së pasi plotëson Formularin 2 – Propozimi i Projektit të Investimit, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në Aneksin 1 të Procedurave të Menaxhimit të Investimeve Publike miratuar me VKM 185 dt.29.03.2018, ruan ndryshimet dhe e dërgon për miratim tek Drejtuesi Ekipit të Menaxhimit të Programit.
- Anëtari i EMP-së, ka të drejtë të propozojë rishikimin e projekteve/produkteve ekzistuese apo futjen e një projekti/produkti të ri dhe dërgon për miratim tek Drejtuesi Ekipit të Menaxhimit të Programit.
- Drejtuesi i çdo Ekipi të Menaxhimit të Programit miraton ose refuzon propozimin për transferim midis projekteve/produkteve ekzistuese apo edhe futjes së një projekti /produkti të ri dhe dërgon për miratim tek dhe nëpunësi autorizues.
- Pas miratimit nga NA, të projektit/produktit të ri, në sistem gjenerohet Kodi i ri, i përkohshëm. Kodet e gjeneruara bëhen të vlefshme pas miratimit përfundimtar të projektit/produktit të ri nga MFE.

3. Përgjegjësitë e përdoruesve në modulën e Monitorimit të Buxhetit dhe Portofolit të Projekteve

3.1. Strukturat përgjegjëse për monitorimin e buxhetit dhe monitorimin e investimeve publike

- Strukturat përgjegjëse për monitorimin e buxhetit dhe monitorimin e investimeve publike, në Drejtorinë përgjegjëse për buxhetin, kanë akses me të drejta të plota në modulën e Monitorimit të Buxhetit dhe Portofolit të Projekteve (BPPM).
- Strukturat përgjegjëse për monitorimin e buxhetit dhe monitorimin e investimeve publike, në strukturat përgjegjëse për buxhetin në ML/IB, në procesin e hartimit të raporteve të monitorimit (periodike dhe vjetore) sigurojnë të dhëna nga raportet përkatëse të modulit Monitorimit të Buxhetit dhe Portofolit të Projekteve (BPPM).
- Strukturat përgjegjëse për monitorimin e buxhetit dhe monitorimin e investimeve publike, në strukturat përgjegjëse për buxhetin në ML/IB, raportojnë në MFE në përputhje me rregullat dhe procedurat e monitorimit të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse në fuqi (udhëzime, VKM, etj), nga Ministri përgjegjës për financat.

4. Drejtoria e SIMF

- Struktura përgjegjëse për administrimin e Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar, ofron mbështetje funksionale për modulet PBA, MIP dhe BPPM dhe Ueb-Portal, bashkëpunon me përdoruesit për problemet e funksionimit të sistemit, zgjidh problemet e përdoruesve ose i adreson ato pranë drejtorive përkatëse, sipas rastit.
- Analizon, modelon dhe nxjerr raporte për monitorimin e performancës së përdoruesve të sistemit.
- Siguron përdorimin me korrektësi të manualeve të përdorimit, asiston në trajnimet e përdoruesve të sistemit me qëllim lehtësimin e kuptueshmërisë dhe transferimin e njohurive.
- Krijon një grup të ri buxhetor kur është miratuar me një akt ligjor ngritja e një njësie të qeverisjes qendrore mbështetur në kërkesën zyrtare të paraqitur nga njësia e qeverisjes qendrore.
- Fshin një grup buxhetor kur ky i fundit është i sapo krijuar dhe nuk është përdorur asnjëherë në modul. Për grupet ekzistuese të cilat kanë të dhëna në modul dhe mbështetur në një akt ligjor pushojnë aktivitetin e tyre, bën ç'aktivizimin e tyre në modul ose aktivizimin kur lind e nevojshme me kërkesë zyrtare të njësisë së qeverisjes qendrore.
- Krijon një program buxhetor kur ky i fundit është krijuar i ri mbështetur në kërkesën zyrtare të paraqitur nga njësia e qeverisjes qendrore të aprovuar nga struktura përgjegjëse për planifikimin buxhetor.
- Fshin një program buxhetor kur ky i fundit është i sapo krijuar dhe nuk është përdorur asnjëherë në modul. Për programet buxhetore, të cilat kanë të dhëna në modul dhe mbështetur në një akt ligjor pushojnë aktivitetin e tyre, bën ç'aktivizimin e tyre në modul ose aktivizimin me kërkesë zyrtare të njësisë së qeverisjes qendrore.
- Ndryshon formatet e raporteve ekzistuese dhe/ose krijon raporte të reja në modulin e Monitorimit të Buxhetit dhe Portofolit të Projekteve (BPPM) me kërkesë të strukturave përgjegjëse për monitorimin e buxhetit dhe monitorimin e investimeve publike.

